



Tiranë, në 01.03.2012

## **NJOFTIM PËR SHTYP**

### **Mbi mbledhjen e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar, datë 28 shkurt 2012**

---

Në vijim të nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit mes institucioneve anëtare, në datën 28.02.2012, në Ministrinë e Financave u zhvillua mbledhja e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF). Mbledhja u kryesua nga Ministri i Financave dhe në të morën pjesë Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Nënkryetari i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të shoqëruar nga personeli ndihmës.

Mbi bazën e informacionit të paraqitur nga institucionet pjesëmarrëse, GKSF-ja shqyrtoi gjendjen e sistemit financiar në vend e posaçërisht të sektorit bankar, duke e vlerësuar atë të mirëkapitalizuar dhe likuide, pra të qëndrueshme. GKSF-ja konstatoi se zgjerimi i veprimtarisë së sektorit bankar është mbështetur kryesisht prej ecurisë në rritje të depozitave të bizneseve e të individëve, si në lekë ashtu edhe në valutë. Gjatë vitit 2011, kreditimi i sektorit bankar për ekonominë u rrit me një ritëm më të lartë se ai i vitit 2010. Gjithashtu, ritmi i rritjes së kredisë në lek ishte më i lartë se ai i kredisë në valutë. Megjithatë, treguesit e cilësisë së kredisë kanë shënuar rënie, ndonëse me një ritëm të ngadalësuar. Si rezultat, në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullativ mbikëqyrës, sektori bankar ka rritur nivelin e fondeve rezervë për zbutjen e rrezikut të kreditit. Rritja e fondeve rezervë është shoqëruar me uljen e nivelit të rezultatit financiar pozitiv.

GKSF-ja vlerësoi se objektivi për përmirësimin e cilësisë së kreditimit duhet trajtuar me përparësi dhe në mënyrë të zgjeruar e të plotë. Ky është një element i nevojshëm për të çliruar potencialin e konsiderueshëm që ka sektori bankar për financimin e projekteve të vlefshme të investimit që vijnë nga familjet dhe bizneset. Në këtë kuadër GKSF-ja vlerësoi rezultatet paraprake të punës së nisur nga një grup i posaçëm ndër-institucional për identifikimin e zgjidhjeve ligjore dhe operationale, të cilat lehtësojnë procesin e ekzekutimit të kolateraleve si dhe nxiti konkretizimin e tyre nëpërmjet zbatimit të ndryshimeve sipas një plani veprimi të posaçëm. GKSF-ja vlerësoi që përbërja dhe objekti i punës së këtij grupi pune mund të zgjerohet, duke synuar identifikimin dhe zbatimin e përmirësimeve të tjera rregullative dhe operationale në veprimtarinë e kreditimit. Përmirësimi i gjendjes së likuiditetit të bizneseve do të ndikonte pozitivisht në përmirësimin e cilësisë së kredisë të sektorit bankar. Për këtë

arsye, GKSF-ja i sugjeron Qeverisë që të ndikojë për kryerjen në kohë të pagesave ndaj kontraktorëve të sektorit privat që zbatojnë projekte të ndryshme të Qeverisë, në përputhje me përcaktimet ligjore për ruajtjen e treguesve fiskalë.

Në mbledhje u diskutua edhe mbi situatën e likuiditetit në tregun ndërbankar dhe në tregun primar të letrave me vlerë të borxhit të qeverisë. GKSF konstatoi një rritje të luhatshmërisë së normave të interesit në tregun primar të letrave me vlerë të borxhit të Qeverisë, në ankandet e fundit por vlerësoi se kjo duhet të jetë një dukuri e përkohshme që reflekton ndryshime të tilla të kërkesës dhe të ofertës dhe është, sidoqoftë, shenjë e një tregu që funksionon. Një planifikim më i mirë i këtyre ndryshimeve si edhe shtrirja e ndikimit të tyre në kohë, do të përmirësonte pritjet e operatorëve në treg, duke ruajtur qëndrueshmërinë në ecurinë e normave të interesit për periudhën në vazhdim. Në kuadër të objektivit të përgjithshëm për zgjerimin e pjesëmarrësve në tregun primar të letrave me vlerë të borxhit të Qeverisë, GKSF-ja mbështeti marrjen e masave me qëllim zgjerimin e pjesëmarrjes të individëve dhe shoqërive të sigurimit që operojnë në vend.

Në mbledhje, GKSF-ja shqyrtoi edhe zhvillimet më të fundit në tregjet financiare ndërkombëtare dhe vlerësoi se situata mbetet e komplikuar, pavarësisht nga disa zhvillime pozitive në vendet e Eurozonës, ku veçohet arritja e marrëveshjes për ndihmën financiare ndaj Greqisë. Ndonëse treguesit e mirë të kapitalizimit dhe të likuiditetit të veprimtarisë përfaqësojnë një bazë të shëndoshë mbrojtjeje për sistemin tonë financiar, GKSF-ja nxiti autoritetet që të monitorojnë me kujdes zhvillimet ndërkombëtare dhe të marrin paraprakisht masat e nevojshme, rregullative dhe operacionale, me qëllim që të kufizojnë në masën më të madhe të mundshme ndikimin e këtyre zhvillimeve mbi sistemin tonë financiar. Gjithashtu, GKSF-ja i nxiti autoritetet publike të vijojnë, me përparësi dhe në mënyrë të harmonizuar, punën për përmirësimin e bazës ligjore, forcimin e bashkëpunimit si edhe fuqizimin e kapaciteteve të tyre njerëzore, financiare dhe teknike, në kuadër të objektivit për parandalimin dhe trajtimin e rreziqeve në sistemin financiar, si edhe për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së tyre. Në këtë kuadër, GKSF-ja vlerësoi se memorandum i mirëkuptimit i nënshkruar së fundi mes autoriteteve anëtare, identifikon disa objektiva konkrete dhe mundëson një harmonizim më të mirë të punës së autoriteteve në ushtrimin e rolit të tyre për ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar.

Në përfundim, GKSF-ja planifikoi që mbledhja e ardhshme të zhvillohet në muajin maj të vitit 2012.